



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Primjens/Prodato Received/Delivered	28.02.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPM&DK	1019/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 47/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.47/2022 të datës 21.01.2022, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "masë disiplinore, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.47/2021 e datës 21.01.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet masa disiplinore "Vërejtje" e datës 23.12.2021, e shqiptuar ndaj ankuesit, nga Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. Detyrohet Zyra për Burime Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil masën disiplinore sipas pikës 2 të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Zëvendësues i Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 21.01.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të shqiptuar ndaj tij, nga Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes emailit zyrtar të datës 23.12.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 31.01.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme (tutje referuar MPB), ndërsa më datë 09.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 633/2022, së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolejji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesën A. nr.47/2022 të datës 21.01.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-maili i datës 24.12.2021 nga ankuesi drejtuar ministrit e-mailin e datës 23.12.2022 të zv. Sekretares së Përgjithshme për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankuesit, e-mailin e datës 25.11.2021 dërguar nga Menaxheri i Personelit në Inspektoratin e Punës, për lidhur me dorëheqjeje e Vendimin me numër protokolli 175 të datës 22.12.2021, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.01.2022, Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 146/2022 të datës 04.02.2022; e-mailin e datës 20.10.2020 nga drejtuar e-mailin e datës 24.09.2021 nga drejtuar ankuesit e-mailin e datës 08.02.2022 nga drejtuar Tahiri; e-mailin e datës 16.11.2021 nga drejtuar e-maili i datës 10.12.2021 nga drejtuar e-mailin e datës 02.12.2021 nga drejtuar e-mailin e datës 01.11.2021 nga drejtuar e-mailin e datës 28.10.2021 nga drejtuar e-mailin e datës 02.12.202 nga drejtuar e-mailin e datës 22.12.2021 nga drejtuar e-mailin e datës 10.12.2021 nga drejtuar e-mailin e datës 03.12.2021, nga drejtuar e-mailin e datës 13.12.2021 nga drejtuar e-mailin e datës 08.02.202 nga drejtuar

Kolejji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas shqyrtimit të provave ndërlidhur me çështjen në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga vlerësimi i provave të lëndës Kolejji ka gjetur së ankuesi në kohën e shqiptimit të masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë, ka ushtruar detyrën e Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë në kuadër të MPB-së. I njëjti me datë 25.11.2021 ka pranuar nga Menaxheri i Personelit të Inspektoratit të Punës, shkresën për dorëheqjen e Kryeinspektorit të Punës Ndërsa me datë 23.12.2021, Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e MPB-së në cilësi të Mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankuesit, përmes emailit ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetimin se: "me datë 25.11.2021, keni pranuar njoftimin për dorëheqjeje të z. Kastrati dhe nuk keni ndërramrrë asnjë veprim, që se paku te na njoftoni me dorëheqjen e tij. Si pasojë e mos informimit nga ana e juaj Ne (unë dhe ministrit) i kemi nënshkruar dokumentet përkatëse dhe e kemi dërguar në Qeveri për rend të ditës në mbledhjen e kësaj jave Vendimin për lirim nga detyra e Kryeinspektorit të punës. Si pasojë e neglizhencë suaj, mos përmbushje së detyrave të punës ju na keni vendosur në lajthitje"



Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshill, pretendon se mos njoftimi i Sekretarës së Përgjithshme lidhur me dorëheqjen e Kryeinspektorit të punës, gjë që nuk ishte kërkuar me parë nga ai, nuk përbenë neglizhencë në punë dhe nuk ka vendosur në lajthitje ministrin dhe sekretare, pasi që rasti ishte duke u trajtuar brenda afatit ligjor dhe se një informim i dorëheqjes do të bëhëj me rastin e dërgimit të vendimit për lirim nga shërbimi civil.

Organi i punësimit, repsektivisht Ministria e Punëve të Brendshme në përgjigjen në ankesë deklaroi se ankuesi në cilësinë e Drejtorit të DMZP, nuk ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me dorëheqjen e Kryeinspektorit të Punës, ashtu siç ishte kërkuar nga vet ai në letrën për dorëheqje.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatesisht nenin 62 ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësi civil lirohet nga Shërbimi Civil edhe kur jep dorëheqjen nga detyra.* 2. *Nëpunësi civil njofton dorëheqjen me shkrim te Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit ku ushtron detyrën, ose te njësia përgjegjëse në rastin e nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese* 3. *Dorëheqja ka pasoja juridike 30 ditë nga data e paraqitjes.* 4. *Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, në raste të arsyetuara, me kërkesë të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë së përcaktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, dorëheqja ka pasoja juridike përpara afatit 30 ditor nga njoftimi, si dhe nenin 90 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin parashihet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se Letër dorëheqja nga Shërbimi Civil i Kryeinspektorit të Punës ishte dorëzuar me datë 25.11.2021, ndërsa ankuesi Vendimin për lirimin e tij nga shërbimi civil e ka nxjerrë me datë 22.12.2021, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se vendimi në fjalë është nxjerrë brenda afatit ligjor të përcaktuar me dispozita ligjore.**

Përkitazi me përgjegjësinë e ankuesit që është dashur të njoftoj ministrin dhe Sekretaren e Përgjithshme të MPB-së lidhur me letër dorëheqjen e ish Kryeinspektorit të Punës, Kolegji nga administrimi i shkresave të lëndës të dërguara nga vet MPB-ja, nuk ka gjetur ndonjë rregull apo procedurë që provon një obligim të tillë të ankuesit në pozitën e Drejtorit të DMZP-së. Në këtë kontekst, Kolegji sipas emalit të datës 22.12.2021 ka vërtetuar se ankuesi me rastin e përcjelljes së Vendimit me numër protokolli 1751 për lirim nga shërbimi civil të ka mbajtur të informuar Sekretaren e Përgjithshme. Ndërsa, sa i perketë obligimit të ankuesit që ta njoftoi Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me aktin e dorëheqjes se ish Kryeinspektorit të Punës, Kolegji nisur nga fakti se Inspektorati i Punës tani vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, vlerëson se vet ish Kryeinspektori i Punës me rastin e dorëheqjes është dashur të njoftoi edhe Ministrin për Financa, Punë dhe Transfere si epror të tij, e mbi këto arsye rezulton se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Në aspekt të vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ju referua nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: 1. *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2.*

kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, respektivisht nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke u bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga elementet që do të bënte përgjegjës ankuesin lidhur me shkeljen disiplinore për të cilën pretendohet nga Zv. Sekretarja e Përgjithshme e MPB-së, kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.47/2022

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshëm;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,

